



STRUKTURAT DREJTUESE TË PARTIVE POLITIKE

RAPORT ANALITIK

Afrim KRASNIQI

1/1/2017

Materiali paraqet pikëpamjet e ISP dhe të autorit mbi problematikën e fokusuar. Projekti është mbështetur nga FES dhe zhvillohet në kuadër të angazhimit të ISP mbi monitorimin e demokracisë së brendshme në partitë politike shqiptare

HYRJE

Instituti i Studimeve Politike (www.isp.com.al) i mbështetur nga Fondacioni Friedrich Ebert (www.fes-tirana.org) vijon edhe gjatë vitit 2017 të monitorojë demokracinë e brendshme në partitë politike shqiptare. Gjatë vitit 2016 është publikuar një studim me gjetjet kryesore, gjetje të cilat u konfirmuan në tërësi edhe në raportin e parë mbi DBP gjatë vitit 2017. Pjesë e këtij procesi monitorimi dhe analize është edhe ekzistenca dhe funksionaliteti i strukturave vendimmarrëse të partive politike konkurruese në zgjedhjet parlamentare të qershorit 2017.

Gjetjet e studimit tregojnë se partitë politike shqiptare vijojnë të funksionojnë me standarde të ndryshme nga normat statusore dhe parimet organizative të përcaktuara nga Ligji mbi Partitë Politike (2010, i ndryshuar), si dhe Kushtetuta e Shqipërisë (neni 9). Koncepti i strukturave brenda partive politike, sidomos legjitimiteti dhe vendimmarrjet e tyre, ende nuk respektohet dhe as trajtohet me standardet e partive moderne politike anëtare të PES apo EPP. Partitë kryesore politike shqiptare, përfshirë partitë e mëdha politike, vijojnë të kenë disbalancë midis pushtetit të madh të kryetarit të tyre dhe ndikimit minimal të anëtarësisë së partisë dhe strukturave të tjera statusore.

Raporti monitorues tregon se në shumicën e partive politike konkurruese në zgjedhjet parlamentare 2017 mungojnë tërësisht të dhënat mbi stafet drejtuese dhe vendimmarrjen, të dhënat për organizimin dhe zgjedhjet, nuk ka respekt të detyrimeve statusore për zgjedhje periodike dhe as cilësi zgjedhore në rastin kur ato formalisht zhvillohen. Në partitë tona politike vijon të mos ketë rotacione elitash, reformim dhe transparencë, sjellje institucionale dhe vendimmarrje mbi një bazë të gjerë përfaqësuese dhe konsultuese.

Dobësimi i strukturave partiake dhe partive politike sjell automatikisht edhe dobësimin e cilësisë së përfaqësimit dhe të demokracisë në Shqipëri. Fiktiviteti në zgjedhjet dhe vendimmarrjet brenda partive politike përkthehet më pas me zgjedhje fiktive dhe vendimmarrje jo transparente në shoqëri, në institucione, në jetën politike dhe publike, ku partitë kanë rol thelbësor dhe në rastin e Shqipërisë, mbi-pushtet absolut.

Bazuar në këto konkluzione dhe vlerësime del jetike dhe emergjente nevoja për reformimin e partive politike, duke filluar nga reformimi tërësor i legjislacionit mbi partitë, për ta bërë atë sa më të përputhshëm me parimin kushtetues të partive me organizim demokratik dhe me transparencë financimi.

PARTITË POLITIKE DHE FUSHATA ZGJEDHORE 2017

Zgjedhjet parlamentare 2017 përbëjnë rast studimi të veçantë për ecurinë e tyre, subjektet konkurruese, rezultatet dhe zhvillimet parazgjedhore. Ato u paraprinë nga një proces politik tre mujor bojkotues i opozitës, nga shtyrja e zgjedhjeve nga 18 në 25 qershor, si dhe nga një marrëveshje politike midis PS e PD, përmes të cilës u penalizuan partitë e tjera politike dhe u legjitimua rezultati zgjedhor. Këto zgjedhje patën numrin më të vogël të subjekteve elektorale ndër dy dekadat e fundit, - vetëm 18 parti politike, asnjë koalicion elektorale dhe asnjë kandidat të pavarur.

- ❖ Konkretisht, bazuar në Kodin Zgjedhor në RSH, deri në afatin ligjor (16 prill 2017) ishin regjistruar në KQZ 46 parti politike, ku nuk bënë pjesë partitë kryesore të opozitës, të cilat fillimisht refuzuan regjistrimin. Afati zyrtar për regjistrimin e kandidatëve ishte data 16 maj, i ri-shtyrë deri më 7 maj, kur u regjistruan kandidatët e 15 partive politike. Pas marrëveshjes politike midis PS e PD (18 maj) afati për partitë e opozitës u shty për datën 25 maj, dhe për rrjedhojë, më 30 maj KQZ regjistroi edhe kandidatët e tri partive politike, Partia Demokratike, Partia Republikane dhe Partisë Bashkimi Demokristian. Dy partitë e mëdha arritën akord në marrëveshjen e tyre për të pamundësuar koalicionet parazgjedhore, për pasojë, një sërë partish të vogla politike të majta e të djathta mbetën jashtë garës elektorale, pasi afatet e regjistrimit jashtë koalicioneve skaduan.
- ❖ Nga 18 parti politike konkurruese në zgjedhjet 2017, bënë pjesë dy parti të reja politike, LIBRA (Lista e Barabartë) dhe SFIDA (Sfida për Shqipërinë). Gjithashtu në zgjedhje hynë edhe dy parti të tjera, që kanë ekzistuar më parë, por që u morën nga drejtues të rinj politikë, - APD (Aleanca Popullore për Drejtësi) dhe PBDKSH (Partia Bashkimi Demokristian Shqiptar). Nga katër partitë, dy prej tyre, LIBRA e PBDKSH drejtoheshin nga ish deputetë të PS në legjislaturën 2013-2017, përkatësisht Ben Blushi dhe Eduart Ndocaj.
- ❖ Ky bilanc formal i subjekteve konkurruese dallon shumë nga përvoja parlamentare e vitit 2013 dhe 2015. Konkretisht, në zgjedhjet parlamentare 2013 morën pjesë 66 parti politike dhe dy kandidatë të pavarur. Nga këto 37 parti politike ishin pjesë e koalicionit të majtë Aleanca për Shqipërinë Evropiane (ASHE), 25 ishin pjesë e koalicionit të djathtë Aleanca për Punësim, Mirëqenie dhe Integrim (APMI), 4 parti konkurruan më vete jashtë koalicioneve. Dy kandidatët e pavarur i përkisnin politikanëve të majtë, një nga PS (Vlorë) dhe një nga LSI (Fier). Nga 37 partitë e majta, vetëm 4 subjekte fituan mandate parlamentare (PS, LSI, PBDNJ dhe PKD), nga 25 partitë e djathta vetëm 3 fituan mandate (PD, PR dhe PDIU), kurse nga partitë jashtë koalicionit asnjëra prej tyre nuk arriti të fitojë mandat parlamentar.
- ❖ Në zgjedhjet lokale 2015 morën pjesë 60 parti politike dhe disa kandidatë të pavarur. Në koalicionin e djathtë Aleanca Popullore Për Punë dhe Dinjitet (APPD) u regjistruan 15 parti politike, nga të cilat vetëm PD e PR kishin mandate parlamentare. Në koalicionin e majtë Aleanca për Shqipërinë Evropiane (ASHE) u regjistruan 37 parti politike, ku bëjnë pjesë tri parti parlamentare PS, LSI dhe PDIU. Jashtë koalicioneve të mëdha konkurruan 8 parti e subjekte politike nga 11 të regjistruara në KQZ, midis të cilave edhe dy parti parlamentare, PBDNJ e PKD. Për kryetar bashkie konkurruan 14 kandidatë të pavarur, për këshilltarë konkurruan 12 kandidatë të pavarur.

Për shkak të ndryshimeve të rëndësishme që ndodhën në procesin parazgjedhor dhe në numrin e subjekteve të regjistruara në zgjedhje, u kufizua edhe objekti monitorues i Institutit të Studimeve Politike mbi strukturat e partive politike konkurruese. Në janar 2017 pritej që nga 66 subjekte elektorale të vitit 2013 dhe 60 subjekte të vitit 2015 të kishte një numër relativisht më të lartë të subjekteve konkurruese. Duke marrë parasysh edhe subjektet e paregjistruara të opozitës në afatin ligjor 16 prill 2017, numri total i partive, koalicioneve dhe kandidatëve të pavarur pritej të ishte midis 70-75, por për shkak të marrëveshjes PS-PD të 18 majit për evitim të koalicioneve paraelektorale dhe pamundësinë de facto për kandidatët e pavarur, - numri i subjekteve elektorale ra në 18 ose 75% më pak.

RËNDËSIA E STRUKTURAVE PARTIAKE DHE KUSHTETUTA E RSH

Kushtetuta e RSH (neni 9), përcakton se *“partitë politike krijohen lirisht. Organizimi i tyre duhet të përputhet me parimet demokratike”*. Konceptet e *“organizimit”* dhe të *“parimeve demokratike”* zgjerohen më tej në ligjin organik mbi partitë politike (2000), i ndryshuar disa herë.

- ❖ Sipas nenit 10 të ligjit mbi partitë politike¹ *“pasi mbledhja e anëtarëve themelues të partisë politike të ketë miratuar dokumentet e partisë, programin, statutin, si dhe organet drejtuese të saj, duhet të paraqitet në gjykatë kërkesa për regjistrimin e saj”*. Pra, ligji detyron partitë që të kenë organe drejtuese të verifikueshme dhe nënkupton detyrimin se çdo ndryshim të reflektohet në regjistrin e Partive Politike në Gjykatë.
- ❖ Më tej, i njëjti ligj, në nenin 7 përcakton 7 rastet e ndalimit të regjistrimit të një partie politike. Në pikën e parë theksohet rasti kur *“organizimi i saj i brendshëm është në kundërshtim me parimet demokratike dhe, veçanërisht, me parimet vijuese: ndërtimi nga poshtë lart i partisë, zgjedhjet e brendshme demokratike për forumet e partisë, e drejta e shprehjes së mendimit nga çdo anëtar, liria e hyrjes dhe e daljes së tyre nga partia, e drejta e çdo anëtari për të zgjedhur e për t’u zgjedhur”*.

Me ndryshimet kushtetuese 2016, u fut kriteri ndalues për kandidatët që duan të konkurrojnë për Gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese (neni 126), Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë (neni 136), Këshillit të Lartë Gjyqësor (neni 147), Inspektorin e Lartë të Drejtësisë (neni 147/b), Prokurorin e Përgjithshëm (neni 148b), anëtarët e Komisionit dhe gjyqtarëve të Kolegjit të Apelit (Neni C, Aneksi kushtetues mbi rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve), si dhe funksioni i magjistratit dhe aplikimi për magjistrat. Në legjislacionin plotësues të reformës në drejtësi është përcaktuar se shprehja *“nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në një parti politike”* do të thotë që *“nuk ka qenë anëtar i organeve drejtuese të parashikuara në statutin e partisë politike”*, pra bazë referimi merren organet e krijuara në statutet e partive politike. Kjo, pasi supozohet se vetë partitë politike funksionojnë mbi bazën e statuteve të tyre, të miratuara në Kongrese/Konventa/Kuvende Kombëtare dhe të depozituara, si rregull, pranë Gjykatës së Faktit Tiranë.

Nga monitorimi i Institutit të Studimeve Politike në qershor 2017, në Regjistrin mbi partitë politike në gjykatën e shkallës së parë Tiranë, figurojnë 130 parti politike, nga të cilat, asnjë parti politike nuk ka depozituar rregullisht të dhënat mbi organet drejtuese dhe ndryshimet periodike statusore dhe programore. Gjithashtu, të dhënat e monitorimit tregojnë se dokumentet statusorë të partive politike (sidomos të partive parlamentare) ofrojnë interpretime të

¹ Ligj nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar, shpallur me dekretin nr.6902, date 22.2.2011.

ndryshime për kategorinë “*pozicione drejtuese në një parti politike*”, siç citohet në Kushtetutën e RSH. Në statute citohen organet drejtuese në parti, ku përfshihen: *Kryesia, Këshilli Kombëtar/Asambleja Kombëtare, Sekretariati, Koordinatorët Politikë*, etj. Gjithashtu, në emërtimin “*strukturë drejtuese*” ose “*forume drejtuese*”, referuar statuteve të partive politike, rezultojnë të përfshihen grupet parlamentare, grupet e këshilltarëve dhe të zgjedhurve në pushtetin vendor në rang vendi, struktura drejtuese e organizatave partnere, drejtuesit e strukturës së garancive statusore, të departamentit të financës në parti, të KOP, të fondacioneve politike pranë partive, etj.

Paqartësitë në përcaktimin e referencës së saktë mbi strukturat, mbi verifikimin e mundshëm të tyre, mbi mënyrën sesi funksionojnë partitë politike dhe midis bazës kushtetuese për reformën në drejtësi dhe legjislacionit aktual mbi partitë politike, - krijojnë hapësira të dukshme abuzimi dhe keqinterpretimi. Për këtë arsye, në janar 2017 dhe më pas në gusht 2017 ISP iu drejtua Kuvendit të Shqipërisë, me sugjerimin që përmes një ndërhyrje të qartë ligjore kalimtare në ligjin mbi partitë politike, të përcaktojë natyrën e regjistrimit të deklarimeve gjatë 10 viteve të fundit për secilën parti politike, strukturën përgjegjëse monitoruese dhe praktikën e verifikimit të deklarimeve/vet-deklarimeve. Kërkesa nuk është marrë ende në konsideratë dhe Kuvendi nuk ka ndërmarrë asnjë veprim ligjor për të mundësuar zbatimin integral të kriterit kushtetues që lidhet me funksionet në partitë politike.

Janë këto elementë thelbësorë juridikë, - Kushtetuta, ligji dhe reforma në drejtësi, të cilat i japin vlerë të veçantë ekzistencës dhe transparencës mbi strukturat vendimmarrëse në partitë politike dhe mënyrës së funksionimit të tyre. Përveç tyre, në zgjedhje qytetarët votojnë për partitë politike dhe ofertat e tyre elektorale (programin dhe kandidatët)

PARTITË NË GARË 2017: DOMINUESE FORMALITETI I STRUKTURAVE

Gjatë monitorimit të subjekteve politike që konkurruan në zgjedhjet parlamentare 2017, rezultuan të dhëna interesante rreth raportit midis kërkesave të ligjit dhe praktikave të mira të funksionimit të partive si dhe gjendjes reale të tyre.

- ❖ Konkretisht, tabela e hartuar nga ekspertët monitorues të ISP paraqet në detaje gjendjen e 18 subjekteve elektorale 2017. Prej tyre vetëm 5 subjekte fituan zyrtarisht mandate parlamentare (PS, PD, LSI, PDIU, PSD), disa parti të tjera fituan mandate indirekt duke qenë pjesë e listave shumë-emërore të PD (PDK, PBDNJ, PR, LZHK), por nuk mund të kenë statusin e partive parlamentare. Nga 18 subjektet konkurruese 15 kanë përfaqësim në qeverisjen vendore përmes këshilltarëve, - tri partitë e mëdha kanë midis 290-390 këshilltarëve, kurse ka parti politike, të cilat vetëm 2-3 këshilltarë në rang kombëtar.
- ❖ Referuar të dhënave, vetëm 4 subjekte partiake ndryshuan kryetarët e tyre ose i konfirmuan ata përmes votimit, nga të cilët dy u zgjodhën me votim të hapur dhe mirëbesim (LSI dhe APD), një me votim formal konkurrues (PD), si dhe një mori një parti tjetër duke u shpallur kryetar i saj (PDKSH). Disa parti zhvilluan zgjedhje për kryetarë më 2016 (PS, LSI, PBDNJ, LIBRA, SFIDA, etj), pjesa tjetër (shumica e 18 partive) nuk kanë zhvilluar zgjedhje për kryetar prej rreth një dekade. Rasti LSI përbën një përjashtim, për shkak se kryetari Meta u zgjodh President (prill 2017), pas tij me votim të hapur dhe pa rivalë u pasua në postin partiak nga Petrit Vasili, i cili pas zgjedhjeve dha dorëheqje, dhe

gjithashtu, me votim të hapur dhe pa rival, u pasua nga Monika Kryemadhi, deputete por edhe bashkëshortja e ish kryetarit Meta.

- ❖ Referuar tabelës, koncepti i zgjedhjeve për kryetar në partitë kryesore shqiptare vijon të jetë formal dhe në kundërshtim me legjislacionin e statutet e partive, të cilat kanë përcaktuar detyrimin e zgjedhjeve periodike në parti çdo 4 ose 5 vjet. Sipas kolonës pasuese të tabelës, midis 18 partive kryesore konkurruese vetëm një parti ka drejtuese një grua politikanë, LSI, edhe ajo e zgjedhur për shkak të përkatësisë familjare me ish themeluesin dhe kryetarin historik të saj partie, zotin Meta. 19 partitë e tjera drejtohen nga politikanë meshkuj.
- ❖ Gjithashtu, referuar të dhënave, tre drejtues politikë nga 18 dhanë dorëheqje pas zgjedhjeve për shkak të rezultatit elektoral (Vasili LSI, Bojaxhiu (SFIDA) dhe Kola APD), kurse kryetarët e partive të tjera jo fituese, nuk zhvilluan analiza, zgjedhje dhe as testim të votëbesimit të tyre. Në PD pati zgjedhje, por kryetari nuk dha dorëheqje, ai “ngriu” postin e tij, megjithatë vijoi ta drejtojë partinë dhe procesin zgjedhor ku vetë ishte edhe konkurrues.
- ❖ Sipas tabelës, 10 nga 18 partitë konkurruese 2017 kanë faqe interneti, por midis tyre vetëm 5 prej tyre (PS, PD, LSI), përfshirë dy partitë e reja SFIDA e LIBRA kanë faqe interneti aktive. Pesë parti të tjera kanë faqe interneti inaktive, kryesisht me deklarime politike dhe lajme të vjetra. Vetëm tri parti (PD, LSI, PS) kanë gazeta partiake online, kurse partitë e tjera kanë komunikim vetëm social me zgjedhësit e qytetarët, përmes deklarimeve në rrjetet sociale dhe në mediat e ditës.

SIGLA E PARTIVE	PARTITE POLITIKE 2017	KRIJUAR NE VITIN	KRYETAR AKTUAL 2017	I ZGJEDHUR ME VOTIM KONKURRUES	MANDAT +/- 4 VJET	DORËHEQJE PAS HUMBJES	KRYESI TE VERIFI-KUESHME	ASAMBLE TE VERI-FKUESHME	ORGANIZATA AKTIVE RINIA/GRAVE	DEPUTETE FITUAR 2017	KESHILLTAR FITUAR 2015
AAK	Aleanca Arbnore Kombëtare	2010	Gjet Ndoj	JO	MBI 4	JO	JO	JO	JO	0	18
AD	Aleanca Demokratike	1992	Eduart Abazi	JO	MBI 4	JO	JO	JO	JO	0	13
ADK	Aleanca Demokristiane	2000	Zef Bushati	JO	MBI 4	JO	JO	JO	JO	0	8
APD	Aleanca Popullore për Drejtësi	2017	Bilal Kola	JO	NEN 4	PO	PO	PO	JO	0	2
PBDKSH	Bashkimi Demokristian Shqiptar	1995	Eduart Ndocaj	JO	NEN 4	JO	JO	JO	JO	0	-
FRD	Fryma e Re Demokratike	2012	Bamir Topi	JO	MBI 4	JO	PO	JO	JO	0	36
LSI	Levizja Socialiste për Integrim	2004	Monika Kryemadhi	JO	4	JO	PO	PO	PO	19	291
LISTA	Partia Lista e Barabartë	2016	Ben Blushi	PO	NEN 4	JO	JO	JO	PO	0	-
PDS	Partia Demokracia Sociale	2003	Paskal Milo	JO	MBI 4	JO	JO	JO	JO	0	26
PDIU	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	2011	Shpetim Idrizi	PO	4	JO	PO	PO	PO	3	61
PSD	Partia Socialdemokrate	1991	Skender Gjinushi	JO	MBI 4	JO	JO	JO	JO	1	6
PS	Partia Socialiste	1991	Edi Rama	JO	MBI 4	JO	PO	PO	PO	74	394
MEGA	Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen	2010	Kristo Kico	JO	MBI 4	JO	JO	JO	JO	0	8
SFIDA	Sfida për Shqipërinë	2016	Hektor Ruci	JO	NEN 4	JO	JO	JO	JO	0	-
PKSH	Partia Komuniste	1998	Qemal Cicolari	JO	MBI 4	JO	JO	JO	JO	0	3
PR	Partia Republikane	1991	Fatmir Mediu	JO	MBI 4	JO	PO	JO	JO	0	63
PKDSH	Partia Kristian Demokratike	2002	Dhimitër Musliu	JO	NEN 4	JO	PO	JO	JO	0	2
PD	Partia Demokratike	1990	Lulzim Basha	PO	4	JO	PO	PO	PO	43	299

Analiza mbi ekzistencën e strukturave drejtuese është gjithashtu kritike:

- ❖ nga 18 subjektet konkurruese të gjitha partitë deklarojnë se kanë kryetar, kryesi, sekretariat apo asamble/këshill. Megjithatë, pasi partive iu kërkua zyrtarisht të dërgonin të dhënat emërore për përbërjen e tyre, vetëm një numër minimal partish arriti të dokumentojë ekzistencën reale të tyre.
- ❖ Konkretisht, 18 partitë kanë kryetar e kryesi, por 10 parti, përfshirë dy partitë e reja LIBRA e SFIDA, nuk ishin në gjendje të ofronin të dhëna nominale zyrtare mbi përbërjen e kryesive (AAK, AD, ADK, PBDKSH, PDS, PSD, PKSH, MEGA). Në disa raste ndonjë prej këtyre partive ofron listë të shkurtër të kryesisë dhe sekretarëve, (deri në 5-7 anëtarë), kur modeli tradicional e statusor i partive tona është kryesia me mbi 19 anëtarë dhe një sekretariat mbi 3-6 anëtarë.

Të dhënat për Asambleshën/Kryesinë janë edhe më kritike sesa për kryesinë:

- ❖ edhe partia më e madhe në vend, Partia Socialiste, nuk ka bërë asnjëherë publike në faqen e saj të internetit përbërjen e Asamblesë Kombëtare. E njëjta gjë vlen edhe për LSI, partia e tretë politike në vend, e cila gjithsesi, e ka publikuar listën e Komitetit Drejtues në një botim special të shtypur, por nuk e publikon online. Lidhur me këto dy parti, argumenti kryesor jozyrtar është se publikimi i plotë i listës do të krijonte debat publik për numrin e madh të zyrtarëve që kanë status civil në administratë dhe që janë pjesë e Asamblesë/Komitetit Drejtues të partive respektive, në kundërshtim me ligjin.
- ❖ Nga partitë e tjera konkurruese në zgjedhjet e qershorit 2017 vetëm APD, PDIU, PD, LSI dhe PS na vuri në dispozicion përmes komunikimit shkresor listën e Këshillit/Asamblesë Kombëtare. Partitë e tjera ose refuzuan dërgimin e përgjigjes (10 parti) ose dërguan të dhëna të përgjithshme dhe jo referuese (FRD, PKD, AD).

ISP kërkoi të dhëna edhe për ekipet drejtuese të partive në degë (kryetarët dhe sekretarët), por asnjë parti politike nuk arriti të ofrojë të dhëna të detajuara. PDIU, PS, PD, PBDNJ ofruan të dhëna të përgjithshme dhe të paplota për kryetarët e degëve, kurse partitë e tjera nuk ishin në gjendje të ofronin as të dhëna pjesore.

- ❖ Strukturat lokale, sidomos të partive të vogla, janë kryesisht të ndërtuara mbi bazën e njohjes personale të kryetarit të partisë dhe për pasojë, ekzistenca dhe funksionimi i tyre varet kryesisht nga interesi dhe aftësia elektorale e kryetarit të partisë.

Lidhur me organizatat partnere, forumet e grave dhe të rinisë, shumica e 18 partive politike nuk kanë struktura të tilla.

- ❖ Të vetmet parti që ishin në gjendje të ofronin të dhëna nominale për kryetarët e organizatave partnere ishin PS, PD, LSI, PR, PDIU, PBDNJ, FRK, PKD, por edhe midis tyre, vetëm tri partitë e mëdha ishin në gjendje të ofronin të dhëna mbi listën e kryesisë së këtyre organizatave partnere.
- ❖ Partitë e tjera më lart nuk disponojnë të dhëna zyrtare mbi kryesinë dhe strukturat lokale të organizatave partnere, kurse partitë e tjera të pa-cituara më lart, por konkurruese në zgjedhjet 2017, nuk janë në gjendje të ofrojnë të dhëna mbi ekzistencën e strukturave formale dhe as funksionale rinore e të grave në nivel qendror apo lokal. Ka pasur raste kur ndonjë parti ka deklaruar se ka koordinator drejtues për organizatën rinore ose të gruas, por në këto raste partia politike e ka pasur të pamundur të ofronte të dhëna nëse ky informacion është funksional dhe legjitim.

TREGUESIT E EFEKTIVITETIT TË STRUKTURAVE NË PARTITË E MËDHA

Në listën e 66 partive politike konkurruese më 2015 dhe 18 partive konkurruese më 2017 vetëm tri parti politike kanë potencial të cilësohen si parti relevante sipas kriterëve të studiuës G.Sartori, - pra parti politike me potencial numerik për krijim ose rrëzim qeverie. Ato janë Partia Socialiste, Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim.

Partitë e tjera të përfaqësuara direkt ose indirekt në parlament gjatë viteve të fundit (PR, PBDNJ, PDIU, PDK, LZHK, PAA, LIBRA etj) nuk kanë potencial numerik për krijim apo shpërbërje mazhorancash parlamentare. Ato mund të kenë ndikim në miratimin e ligjeve të veçanta apo në votime të veçanta ku njëra nga partitë e mëdha nuk ka votat e kërkuara, por në tërësi, ato janë e mbeten parti pa potencial vendimmarrës dhe pa rol me rëndësi në jetën politike në Shqipëri. Kjo vlen edhe në rastin kur një parti ka 4-5 deputetë siç ishin PR e PDIU gjatë mandatit parlamentare 2013-2017, ashtu edhe në rastin aktual, kur PDIU është parti e katërt politike parlamentare me 3 deputetë.

Mbështetur në këto arsye demokracia e brendshme dhe strukturat partiake brenda tri partive të mëdha kanë më shumë vlerë e rëndësi sesa në partitë e vogla politike. Mund të kemi parti të vogla politike (si APD, LIBRA apo SFIDA) që kanë parametra transparentë vendimmarrës dhe funksionimi, por gjithsesi, ato nuk kanë përfaqësim politik të referueshëm në nivel kombëtar, ndaj vlera e tyre është e mbetet simbolike. E kundërta ndodh me tri partitë e mëdha, të cilat kanë potencial për vendimmarrje, kanë ndikim publik, kanë rol thelbësor në zhvillimet politike dhe kanë shtrirje e pretendime të qëndrueshme në nivel lokal e kombëtar. Analiza e mëposhtme i referohet tri partive të mëdha.

PS: STRUKTURA TË PLOTA, POR SISTEM VERTIKAL FUNKSIONIMI

Partia Socialiste (PS) ka struktura të plota organizative. Kryetari i PS është zgjedhur më 2009 dhe përmes një referendumi (mars 2016) fitoi varianti sipas të cilit, kur kryetari është kryeministër mandati i tij drejtues vijon pa ndërprerje. Struktura e dytë është kryesia dhe sekretariati. Kryesia e PS përbëhet nga 16 anëtarë përfshirë kryetari, nga të cilët, pesë janë gra dhe tre janë kryetarë bashkie. Kryesia e PS është zgjedhur më 2016 përmes një procesi konkurrues dhe votimi të fshehtë midis kandidatëve meshkuj dhe paralelisht midis kandidateve femra.

- ❖ Në kryesi bëjnë pjesë edhe zv/kryeministri, si dhe gjashtë ministra. Me përjashtim të tre kryetarëve të bashkisë, të cilët nuk mund të kandidojnë për deputet pa dhënë dorëheqje nga posti, në zgjedhjet parlamentare 2017 nuk kandidoi edhe zv/kryetarja e Kuvendit, Valentina Leskaj. Zonja Leskaj dha dorëheqje paraprake nga kandidimi megjithëse gjerësisht shihet si një politikane me përvojë dhe e maturuar. Nga kryetarët e komisioneve parlamentare, i vetmi anëtar kryesie është Erion Brace. Në kryesi bëjnë pjesë edhe dy drejtuesit kryesorë të grupit parlamentar, Gramoz Ruci dhe Taulant Balla. Në kryesinë e PS nuk bëjnë pjesë kryetarët e organizatave partnere, Olta Xhacka kryetare e Forumit të Grave Socialiste dhe Elio Hyska.
- ❖ Në sekretariatit e PS bëjnë pjesë 8 sekretarë, 7 të zgjedhur në mbledhjen e rregullt të Asamblesë Kombëtare në prill 2016 dhe 1 i zgjedhur më vonë, pas shkarkimit të Sekretarit për Reformën Strukturore dhe Emigracionin Koço Kokëdhima. Duhet thënë se

të gjithë sekretarët janë zgjedhur në Asamble pa votim konkurrues me kandidatë të tjerë, por si kandidatë të vetëm, një preferencë e qartë e konceptit të bashkëpunëtorëve të besuar të kryeministrit Rama. Sekretari më i rëndësishëm është Sekretari i Përgjithshëm Gramoz Ruçi. PS bëhet partia e parë që fut në strukturën drejtuese një Sekretar për organizimin digjital (Alfred Peza). Ilir Beqja ishte ministër i shëndetësisë kur mori edhe detyrën e Sekretarit mbi Programin, i vetmi me dy poste drejtuese në PS dhe i vetmi ministër me post në sekretariat. Sekretarët e tjerë vijnë nga përvoja politike (Fino e Ulqini), nga nevoja për raporte të përfaqësimit gjinor (Spiropali e Gjylameti). Dy nga tetë sekretarët, Peza e Çipa nuk u përfshinë në listën e kandidatëve për deputet, megjithëse supozohej se në një sistem proporcional me lista të mbyllura figurat drejtuese partiake mbajnë peshën kryesore të kandidimit.

- ❖ Struktura e tretë funksionale e PS është Asambleja Kombëtare me 175 anëtarë. PS nuk ka bërë asnjëherë publike në faqen e saj të internetit përbërjen e Asamblesë Kombëtare, megjithëse emrat janë bërë publikë pas votimit nga Kongresi Zgjedhor në mars 2016. Në Asamblenë Kombëtare pati prurje të reja, kryesisht drejtues të enteve publike në qendër e në rrethe, drejtues të zyrave rajonale dhe funksionarë të lartë ekzekutivë. Një nga arsytet e mospublikimit zyrtar të listës lidhet edhe me kontradiktat midis legjislacionit mbi nëpunësit civilë dhe administratën publike dhe statusit partiak në strukturat drejtuese të PS. Një numër funksionarësh partiakë kanë poste civile dhe janë emëruar për shkak të kontributit politik megjithëse vendet e tyre të punës do të duhej të ishin produkt i një konkursi dhe gare transparente me sistemin e meritës dhe profesionalizimit.

Një nga problemet e Asamblesë është debati mbi rolin e deputetëve.

- ❖ Sipas statusit të PS të gjithë deputetët janë anëtarë në Asamble, por pas zgjedhjeve parlamentare 2017 dhe në periudhën e tranzicionit midis zgjedhjeve e qeverisë së re, Asambleja ftoi si anëtarë deputetët e rinj (të pa betuar ende) dhe jo deputetët e vjetër (me status deri në shtator 2017).
- ❖ Mungesa e rregulltave dhe praktikave të qarta të organizimit dhe të funksionimit të strukturave shpesh krijoi debate dhe keqkuptime, - siç ishte rasti i përjashtimit nga Asambleja e deputetit Kokëdhima, kur me status, një anëtar i Asamblesë zgjidhet nga Kongresi dhe vetëm organi zgjedhor mund të bëjë përjashtimin e tij. Po ashtu, Asambleja Kombëtare e PS nuk arriti të marrë vendime mbi dy deputetët e PS, Blushi e Hafizi, të cilët me statusin e PS duhej të ishin njëherësh edhe anëtarë të Asamblesë, ndërkombëtarë që de facto ata krijuan një parti të re politike dhe rivalizuan PS-në në zgjedhje.
- ❖ Elementi i tretë i debatit lidhet me zbatimin e ligjit të de-kriminalizimit dhe kartës së vlerave, të cilën PS propozoi në kongresin e fundit. Asnjë prej deputetëve dhe drejtuesve bashkiakë të penalizuar nga ligji i de-kriminalizimit nuk është pezulluar nga Asambleja dhe nuk ka qenë objekt debati brenda saj, - një devijim nga parimet e mira të organizimit dhe vullnetin politik në kundërshtim të de-kriminalizimit.

Së fundi, strukturat vendimmarrëse të PS, sidomos Asambleja Kombëtare, nuk pati mbledhje të rregullta dhe nuk pati rol në vendimmarrjet më të rëndësishme të PS për vitin 2017, - prishjen e koalicionit politik me LSI, zgjedhjen e Presidentit të ri të Republikës, miratimin e Marrëveshjes së Majit 2017 me PD dhe miratimin e listës për deputetë në zgjedhjet e qershorit. Tre nga katër

vendimet e mësipërme nuk kaluan as formalisht as në kryesinë e PS, duke mbetur në kuadër të konsultimeve në sekretariat dhe rrethin e vogël vendimmarrës të kryetarit.

- ❖ Lidhur me strukturat e tjera, - PS disponon të dhëna të plota për strukturat drejtuese lokale, - koordinatorët e qarqeve, kryetarët e degëve, sekretarët, kryesitë, drejtuesit e organizatave partnere, listën e deputetëve dhe listën e kryetarëve të bashkive dhe të këshilltarëve që i përkasin kësaj partie. Regjistri i të dhënave me të gjitha këto kategori është kryesisht statik, ndryshon me vështirësi, nuk bëhet publik dhe normat statusore nuk garantojnë mbrojtjen e të drejtave të individëve që përfshihen në këto kategori, nëse këto të drejta cenohen nga struktura më të larta të partisë apo nga vetë kryetari.
- ❖ Në PS, sipas statusit ekziston institucioni i Komisionit të Garancive Statutore (KGS), me mandate 4 vjeçar dhe funksion bazë *“vendos për çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin dhe interpretimin e Statutit të Partisë, të vendimeve dhe rregulloreve të forumeve qëndrore të Partisë...Anëtarët e KGS nuk mund të jenë dhe anëtarë të forumeve të tjera qëndrore të partisë”*².
- ❖ Drejtuesi kryesor i këtij organi, Alket Hyseni, ishte funksionar politik si këshilltar i kryeministrit, pra i kryetarit të partisë, zotit Rama. Duke qenë i tillë, ai nuk mund të ishte njëherësh edhe “gjykatës partiak” i pavarur nga kryetari dhe këshilltar i tij. Në zgjedhjet 2017 ai u përfshi në listën shumëemërore për deputet nga PS dhe rezultoi në zonë fituese, duke u bërë njëherësh pjesë e strukturës drejtuese parlamentare. Të dhëna të tilla mbi diferencën midis rregullave të shkruara dhe zbatimit të tyre konkret përbëjnë tipar të qëndrueshëm në këtë parti; ato dobësojnë demokracinë e brendshme dhe garancitë për funksionimin e saj në PS.

PD: REKORD NË STRUKTURA, POR ME NIVEL FORMAL FUNKSIONIMI

Partia Demokratike (PD) ka struktura të plota organizative. Kryetari i PS është zgjedhur më 2013 dhe rizgjedhur më 2017, në dy rastet përmes një votimi konkurrues. Zgjedhjet e vitit 2013 ishin në cilësi, konkurrim, transparencë dhe legjitimitet, më të plota sesa më 2017. Në zgjedhjet e fundit kontestimet e praktikave zgjedhore, organizimit dhe mënyrës së zhvillimit të tyre sollën bojkotimin e procesit nga një fraksion politik brenda partisë, si dhe fiktivitet në administrim në pjesën tjetër të partisë që mori pjesë në votim.

- ❖ Kryesia e PD përbëhet nga një numër i papërcaktuar anëtarësh, në varësi nga postet që kjo parti mban në parlament dhe numri i departamenteve të krijuara brenda saj. Në korrik 2017 kryesia e PD kishte numër rekord për një parti politike shqiptare, plot 47 anëtarë, ku bëjnë pjesë kryetari (1), nënkryetarët (2), Sekretarët (8), drejtuesit e departamenteve (26), si dhe drejtuesit në grup e në komisione parlamentare (10). Si rregull, në kryesi janë edhe krerët e organizatave partnere (2). Në dallim nga PS në kryesinë e PD nuk bën pjesë asnjë prej kryetarëve të bashkive të drejtuara prej saj, si dhe asnjë prej ministrave teknikë pjesëmarrës në kabinetin e verës 2017.
- ❖ Në zgjedhjet parlamentare 2017 nuk u përfshinë në listat e kandidimit nga PD rreth 50% e kryesisë, ose 22 anëtarë të kryesisë, përfshirë pesë sekretarë ku bëjnë pjesë edhe

² Statuti i PSSH, neni 32, Tirane 2016.

përgjegjësit për organizimin (Eno Bozgo) dhe burimet njerëzore (Fatbardh Kadilli). Në listë nuk ishin as kreu i organizatës rinore të PD (Belind Këllici), si dhe disa nga drejtuesit e komisioneve parlamentare (Majlinda Bregu, Genc Ruli, Ridvan Bode). Moskandikimi i tyre shkaktoi debat publik dhe tregoi se vendimmarrja në PD ka deformuar rregullat statusorë dhe bazohet kryesisht në vullnetin personal të kryetarit të partisë dhe bashkëpunëtorëve të tij më të afërm, nënkryetarëve.

- ❖ Bazuar në strukturën organizative të PD, personi i dytë më i rëndësishëm është kryetari i grupit dhe sekretari i përgjithshëm, i pari në nivel politik parlamentar dhe i dyti në nivel politik elektoral. Kreu i grupit parlamentar 2013-2017 Edi Paloka është caktuar pa zgjedhje dhe votim konkurrues apo të fshehtë, kurse Sekretari i Përgjithshëm Arben Ristani është zgjedhur me votim konkurrues dhe të fshehtë, por duke aplikuar jo sistemin e shumicës së votave por vetëm një raund votimi. Të gjithë zyrtarët e tjerë të partisë, përfshirë sekretarët dhe shefat e departamenteve, drejtuesit në komisionet parlamentare dhe koordinatorët kombëtarë, propozohen nga kryetari dhe kalojnë për votim formal në Këshillin Kombëtar. Në PD ky rregull nuk është zbatuar, kryesisht për shkak se Këshilli Kombëtar nuk ka zhvilluar asnjë mbledhje gjatë periudhës së fundit katër vjeçare.

Struktura e tretë funksionale e PD dhe më e rëndësishmja midis dy Kuvendeve Kombëtare është Këshilli Kombëtar me 151 anëtarë.

- ❖ PD është e vetmja parti që e ka bërë publike online listën e Këshillit Kombëtar (<https://demokratet.al/keshilli>), dhe e vetmja nga tri partitë kryesore politike që nuk e ka mbledhur asnjëherë këtë strukturë. Me ndryshimet statusore 2014 në Këshillin Kombëtar do të duhet të bëjnë pjesë kryesia e partisë, edhe ish-presidentët, ish-kryeministrat dhe ish-kryetarët e PDSH, që janë anëtarë të PD në momentin e thirrjes së Këshillit Kombëtar; deputetët; kryetari i Bordit Financiar të partisë; Kryetarët e degëve të PD-së; Kryetarët e organizatave partnere; Drejtuesit e departamenteve të PDSH; Kryetarët e bashkive qendër qarku dhe të bashkive/komuna mbi 40 mijë banorë. Siç shihet, pjesë e Këshillit do të ishin shumë më tepër sesa 151 anëtarë, rreth 230 anëtarë, disa prej të cilëve do të ishin anëtarë në varësi nga mandati i tyre drejtues në degë, në qeverisjen vendore apo në grupin parlamentar.
- ❖ Në momentin e zgjedhjes (2014) të Këshillit Kombëtar, në përbërjen e tij dominuan figurat me poste administrative në nivel qendre dhe lokale, stafet politike dhe administrative të ish kryeministrit Berisha dhe ish kryetarit të bashkisë Tiranë Basha, si dhe individë që kërkojnë imunitet politik për shkak të posteve që kanë pasur dhe akuzave që iu janë bërë apo prurje të reja kryesisht të rinj dhe pa përvojë politike. Kjo është një praktikë e ndjekur nga partitë tona në çdo rast të kalimit në opozitë. Këshilli Kombëtar do të duhej të kishte bashkë-drejtuar me kryetarin të gjitha proceset politike në parti, përfshirë reformimin organizativ, shkrirjen dhe krijimin e degëve të reja, zgjedhjen apo votëbesimin e kryesisë, miratimin e listës për kandidim politik në zgjedhjet lokale e parlamentare, etj, funksione të cilat ai nuk i ka përmbushur në asnjë rast përgjatë 4 viteve. Një nga arsyet e mungesës së funksionalitetit të tij është mungesa e një drejtuesi për Këshillin Kombëtar, praktikë që ndiqet në PS, LSI, por edhe në parti të tjera më të vogla politike, përfshirë aleati kryesor i PD, Partia Republikane.
- ❖ Gjatë katër viteve të fundit ka pasur raste kur ndonjë deputet i PD është larguar nga grupi drejt një grupi tjetër parlamentar (Gjovalin Kadeli) ose përjashtuar (Mesila Doda) etj,

raste si deklarimi politik e dorëheqja nga PD (Lefter Maliqi), raste të emërimit të disa individëve në këshilltarë politikë të funksionarëve të majtë përfshirë presidentin aktual Meta apo raste të emigrimit jashtë vendit dhe të deklarimeve të dorëheqjeve politike, megjithatë asnjë prej këtyre ngjarjeve dhe akteve nuk është pasqyruar në përbërjen e Këshillit Kombëtar të PD dhe as në vendimmarrjet e kryesisë, sekretariatit apo të Këshillit. Rreth 12 raste të tilla figurojnë ende zyrtarisht anëtarë të Këshillit Kombëtar. Të dhëna të tilla nxjerrin në pah fiktivitetin e dukshëm të listës së KK dhe strukturës organizative në PD, si dhe vendimmarrjet me standarde jashtë përcaktimeve e parimeve statusore të kësaj partie.

Lidhur me strukturat e tjera, - PD disponon të dhëna të plota për strukturat drejtuese lokale, - koordinatorët e qarqeve, kryetarët e degëve, sekretarët, kryesitë, drejtuesit e organizatave partnere, listën e deputetëve dhe listën e kryetarëve të bashkive dhe të këshilltarëve që i përkasin kësaj partie.

- ❖ Ashtu si në PS, regjistri i të dhënave me të gjitha këto kategori është kryesisht statik, ndryshon me vështirësi, nuk bëhet publik dhe normat statusore nuk garantojnë mbrojtjen e të drejtave të individëve që përfshihen në këto kategori, nëse këto të drejta cenohen nga struktura më të larta të partisë apo nga vetë kryetari.

Në PD, sipas statusit ekziston institucioni i Komisionit Qendror të Apelit, i cili *“pranon kërkesa të formuluar nga të interesuarit kundër masave disiplinore të marra ndaj tyre. Ai përgjigjet për garantimin e të drejtës për mbrojtje gjatë ushtrimit të masave disiplinore”* si dhe *“me kërkesë të kryesisë së partisë, shprehet për mospërputhjet e vendimeve të marra nga organet qendrore, kryesitë apo anëtarët, me Statutin e Partisë”*.

- ❖ Neni 47 i Statusit përcakton edhe përbërjen dhe mandatin. Komisioni është zgjedhur më 2014 me mandat 4 vjeçar, por asnjëherë përbërja dhe aktiviteti i tij nuk janë bërë publikë. Në burime informale emrat janë të njohur, kryesisht bashkëpunëtorë të afërt të kryetarit të PD dhe mbështetës të tij besnikë në aktivitetin partiak, - një qëndrim që dukshëm cenon pavarësinë dhe integritetin e tyre në rastet hipotetike të shqyrtimit të ankesave që vijnë për pasojë të vendimmarrjeve të kryetarit apo strukturave që kontrollohen prej tij.
- ❖ Në debatin publik që shkarkuan pakënaqësinë në zgjedhjet e brendshme në PD 2017 për kryetar, ky Komision nuk u përfshi duke mos i dhënë përgjigje institucionale asnjë prej pretendimeve, kurse anëtarë të tij ishin aktiv pro pozicionit të kryetarit Basha.

LSI: ROTACIONI I DREJTIMIT BRENDA FAMILJES

LSI mbetet një parti klasike e bazuar tek emri themelues dhe mbështetësit e tij. Ajo nuk është parti me bazë horizontale dhe me grupe mbështetëse sociale të qëndrueshme, por bazuar në emrin themelues (Meta), bashkëshorten e tij (Kryemadhi), si dhe bashkëpunëtorët e tyre ndër vite.

- ❖ Sipas statusit LSI ka disa organe qendrore politike, ku kryesore janë kryetari, kryesia Ekzekutive, kryesia e partisë, sekretariati, Komiteti Drejtues, etj. Kryesia Ekzekutive e LSI përbëhet nga kryetari (M.Kryemadhi), zv/kryetari (L.Rama), Sekretari i Përgjithshëm (E.Brahimllari), dy nënkryetarë (E.Xhixho dhe K.Mehmetaj), si dhe kryetarët e

organizative partnere, Klajda Gjasha (LGI) dhe Floida Kërpaci (LRI). Ajo ndihmohet nga katër sekretarë të tjerë politikë ku bën pjesë edhe sekretari për Sigurinë Kombëtare B.Shaqiri, - e vetmja parti me një post të tillë.

- ❖ Në total LSI ka një kryesi prej 32 anëtarësh, ku bëjnë pjesë kryesia ekzekutive, pjesa më e madhe e deputetëve dhe ministrave të saj, si dhe stafet politike të drejtuesve kryesorë në poste ekzekutive. Në kryesi bëjnë pjesë edhe Spartak Braho, i cili në zgjedhjet 2017 ishte pjesë e listës shumë-emërore të PS në Tiranë dhe pjesëmarrës edhe në mbledhjen e Asamblesë së kësaj partie në fundin e muajit gusht 2017.
- ❖ LSI nuk ka të publikuar listën e Komitetit Drejtues dhe as të drejtuesve lokalë. Megjithatë, ajo ka struktura lokale të sprovuara në disa zgjedhje parlamentare e lokale, si dhe ka organizata aktive partnere. Gjatë mandatit të fundit të strukturave politike të kësaj partie (2012-2017) ato janë mbledhur rregullisht, sidomos kryesia, duke krijuar harmonizim midis detyrimeve statusore dhe jetësimit të tyre praktik. Për vetë natyrën operacionale të saj, kryesia ka qenë më efektive dhe më vendimmarrëse sesa strukturat e tjera, përfshirë Komitetin Drejtues.

Gjatë vitit 2017 LSI u ndesh me sfidën e zgjedhjes së pasuesit të zotit Meta në postin e kryetarit të partisë.

- ❖ Zoti Meta u zgjodh President i Republikës në prill 2017, post i papajtueshëm me angazhimin në një parti politike, përfshirë partinë e themeluar dhe drejtuar prej tij. Menjëherë pas zgjedhjes President Meta dha dorëheqje nga posti i kryetarit, duke propozuar si pasues të tij Petrit Vasilin, numrin dy të partisë. Zoti Vasili u prezantua nga LSI edhe si kandidat për kryeministër në zgjedhje, si dhe u emërua prej saj Ministër i Drejtësisë në qeverinë e përbashkët me PS.
- ❖ Pas marrëveshjes midis PS e PD (17-18 maj 2017) ministri Vasili u shkarkua nga posti dhe LSI u gjend jashtë koalicionit politik elektoral me PS, duke rrezikuar mbijetesën e saj politike në zgjedhje. Për pasojë, zoti Meta përfitoi nga periudha e tranzicionit midis zgjedhjes së Presidentit (prill 2017) dhe marrjes së detyrës si President (korrik 2017) për të drejtuar de facto LSI edhe në procesin zgjedhor të 25 qershorit. Në përfundim të tyre LSI ruajti nivelin e përfaqësimit parlamentar, madje shënoi rritje në mandate dhe vota në krahasim me 2013, por gjithsesi humbi rolin si forcë përcaktuese për krijimin e mazhorancës së re parlamentare dhe krijimin e qeverisë së re.
- ❖ Pas zgjedhjeve kryetari Vasili paraqiti dorëheqje dhe në një mbledhje të zgjeruar të strukturave qendrore dhe lokale të LSI zonja Monika Kryemadhi, deputete, bashkëthemeluese e LSI, por njëherësh edhe bashkëshorte e ish kryetarit Meta, u zgjodh kryetare me votim të hapur dhe pa rivalë. Zgjedhja e saj përbën risi në politikën shqiptare. Asnjëherë më parë një parti politike nuk kishte trashëguar drejtimin e saj brenda një familjeje, dhe se vetë zgjedhja e bashkëshortes në postin drejtues të ish bashkëshortit ishte tregues i qartë i krizës së figurave politike dhe modelit të organizimit të LSI, si parti e bazuar tërësisht në emrin e kryetarit themelues dhe bashkëpunëtorët e tij të afërt.